



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0251
Data e Vendimit: 16.04.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “PM GROUP” SH.P.K. kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale” me numër prokurimi 613-25-376-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Lipjanit, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 16.04.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jashtafatshme, ankesa e OE “PM GROUP” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0251, e datës 08.04.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale” me numër prokurimi 613-25-376-1-2-1, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Lipjanit që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 08.04.2025, ka pranuar ankesën e OE “PM GROUP” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale” me numër prokurimi 613-25-376-1-2-1, të Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 31.01.2025 Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë. AK me datën 20.03.2025 ka publikuar njoftimin B58.

Operatori Ekonomik “PM GROUP” SH.P.K me datë 26.03.2025 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim ne AK të cilët me dt. 26.03.2025 ka publikuar Vendimin lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim.

Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 08.04.2025 me numër të protokollit 2025/0251.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale” me numër prokurimi 613-25-376-1-2-1, me datën 31.01.2025 Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë. AK me datën 20.03.2025 ka publikuar njoftimin B58.

Operatori Ekonomik “PM GROUP” SH.P.K me datë 26.03.2025 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim ne AK të cilët me dt. 26.03.2025 ka publikuar Vendimin lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim.

Ankuesi “PM GROUP” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 08.04.2025 me numër të protokollit 2025/0251.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i të gjithë procedurës së dokumentacionit që gjendet në sistemin e e-prokurimit, konstatohet se OE ankesën në OSHP e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse është publikuar në ditën e njëmbëdhjetë. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim është publikuar me datën 28.03.2025 ndërsa ankesa është parashtruar me datën 08.04.2025, pra në ditën e njëmbëdhjetë.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i të gjithë procedurës së dokumentacionit që gjendet në sistemin e e-prokurimit, konstatohet se OE ankesën në OSHP e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse kanë kaluar dhjetë (10) ditë për parashtrim të ankesës ashtu siç është rregulluar me nenin 109 të LPP-së si dhe nenin 64 paragrafi 1 i Rregullores për Prokurimin Publik ku thuhet: 64.1 “Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së”.

Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Sipas kësaj dispozite ligjore kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A ku çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

“Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji”.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se ankesa e dorëzuar nga OE i sipërcituar është e jashtëaftshme dhe si e tillë nuk mund të futet në shqyrtim.

Autoritetit kontraktues – Komuna e Lipjanit, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale” me numër prokurimi 613-25-376-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - PM GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: